A.K.P.A.
Nr 2921 Prot.
Datë,më 05.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE "SHËN JOZEFI PUNËTOR" RRËSHEN

Nr. 461 prot. Data 04.11.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele **(zëv.raporte paaftësie të përkohshme)**

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar,

Shkolla Profesionale "Shën Jozefi Punëtor", ju njofton krijimin e 1 (një) vendi të lirë pune për pozicionin:

- Mësues të formimit teorik dhe praktik, drejtimi SHMT, me kohë të plotë, 1 (një) person. **(zevendësim raporte paaftësie të përkohshme në punë)**

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kritere të përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës se prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit;

Rr. Preng B. Doda 3, Rrëshen – Mirditë. Tel. 0686499988. Email: Luigj.gjergji@akpa.gov.al

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barazvlershme me të, në drejtimin në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- Të ketë të paktën 1 (nje) vit eksperience pune në fushën në të cilën ka kryer studimet;
- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë të përfshijë:

- Letër motivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin(CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit,që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënëst e mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 12.11.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759, datë 27.05.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTORI

Luigj GJERGJI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Agjencia Kombëtare e Punës dhe Aftësive RRËSHEN

Rr. Preng B. Doda 3, Rrëshen – Mirditë. Tel. 0686499988. Email: Luigj.gjergji@akpa.gov.al